



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM
Nr. 70 datë 06.11.2024

“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR 18 DT 20.07.2023 “PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA/PËRDORIM, TË SIPERFAQES 0.3201ha NË EKONOMIN PYJORE “PRUEMOS SHELDI”, NGA STRA 104, NJ.A GURI ZI, FSHATI SHELDI, PËR AKTIVITETIN INSTALIM TË SHTYLLËS ERËMATESE PËR STUDIMIN E ERËS, AEROGJENERATORË, PËR NJË PERIUDH 12 MUAJ PËR SHOQËRINË “ VOLTALIA ALBANIE”

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 06.11.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja 'e/l' të ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit Nr.115/2014 datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njesive të qeverijes vendore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin Nr.57/2020 “Për pyjet”, Udhëzimin e Ministrisë së Mjedisit Nr.1 datë 9.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik”, VKM Nr.559 datë 29.07.2022 për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjorë kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, i ndryshuar; VKM Nr.684, datë 02.09.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr.433 datë 08.06.2016 të Këshillit Ministrave “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/bashkive”, të ndryshuar dhe sipas sipas dokumentacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

VENDOSI :

1. Të miratojë ndryshimin e paragrafit të fundit të pikës 1 të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr.18 datë 20.07.2023 nga “për një periudhë 12 muaj” në “për një periudhë 24 muaj”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 29 vota
Vota Pro 29
Vota Kundër 10
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 07.11.2024

SEKRETARE

Sabina Danaj



KRYETAR

Oltion LULI

